

Inderuar z.Matlija

Në përgjigje të pyetjeve Tuaja dërguar me email, ku keni kërkuar vënien në dispozicion të disa informacioneve lidhur me veprimtarinë e institucionit tonë, Task-Forcës në varësi të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, ju informojmë se:

Në lidhje me metodologjinë e ndjekur në vendosjen e gjobave në zbatim të Aktit Normativ nr.8 datë 28.12.2023, “Për marrjen e masave urgjente, për mbrojtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës, për trajtimin e ujërave të ndotura që shkarkohen pranë ose në ujëra larëse”, (më poshtë Akti normativ), ju sqarojmë se Task-Forca në varësi të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve, e cila i ushtron funksionet e saj bazuar në dispozitat e përcaktuara në këtë akt normativ, kryen kontrolle në terren ndaj subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari ekonomike pranë ujërave larëse. Kontrollat konsistojnë në verifikimin nëse subjektet e përmendura më lart kanë të vendosur në ambientet e tyre impiantin ose sisteme individuale të trajtimit të ujërave të ndotura. Ato ushtrohen bazuar në planifikimin e inspektimeve, si dhe në analizën e riskut duke u zgjeruar në mënyrë graduale.

Sipas Nenit 4, pika 1 dhe 3 të Aktit Normativ përcaktohet se: *“1. Subjektet që zhvillojnë veprimtari ekonomike sipas pikave 1 deri 12, të nenit 2, të këtij akti normativ, në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve (në vijim subjektet) kanë detyrimin që, **brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ, vendosin impiantin ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas rregullores teknike, të miratuar me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për infrastrukturën dhe të ministrit përgjegjës për mjedisin**” .... “3. Subjektet që kryejnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare ose në bregun e liqeneve e të lumenjve, **të cilat shkarkojnë ujërat e ndotura në gropat septike, marrin masat për zëvendësimin e tyre me impiant ose sisteme individuale, me qëllim trajtimin e ujërave të ndotura, sipas detyrimeve të përcaktuara në këtë akt normativ dhe në rregulloren teknike**”.*

Ndërsa sipas Nenit 6 të Rregullores Teknike, miratuar me Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Energjitikës dhe Infrastrukturës dhe Ministrit të Turizimit dhe Mjedisit nr.01., datë 01.02.2024, “Për miratimin e rregullores teknike mbi standartet për trajtimin e ujrave të ndotur për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotur dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larës” (Rregullorja teknike) përcaktohet se: *“Subjektet që ushtrojnë veprimtari ekzistuese, janë në proces ndërtimi ose kanë aplikuar për leje ndërtimi, në bazë të kapacitetit dhe zgjidhjeve teknike ekzistuese apo që janë planifikuar për t’u zbatuar, **të lidhura ose jo me rrjetin publik të kanalizimeve, duhet të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave të ndotura sipas përcaktimeve të kategorive shprehur në nenin 2, të aktit normativ nr.8, datë 28.12.2023.**”*

Pas periudhës 90 ditore të përcaktuar në nenin 4, pas hyrjes në fuqi të aktit normativ, bazuar në kontrollin e kryer nga inspektorët, në rast konstatimi të kundravajtjes administrative, në varësi të kategorisë së subjekteve sipas parashikimit të pikave 13, 14, 15 të nenit 2, si dhe duke respektuar parimin e proporcionalitetit të parashikuar nga Kodi i Procedurës Administrative, Task Forca procedon me vendosjen e masës përkatëse administrative parashikuar në nenin 8 të Aktit Normativ.

Në lidhje me kërkesën për informacion lidhur me identifikimin e subjekteve, ju sqarojmë se Task Forca kryen kontrollet sipas planifikimit të inspektimeve, të cilat bazohen në analizën e riskut. Në varësi të gjetjeve pas kryerjes së inspektimit përkatës, institucioni vijon me marrjen e masave administrative nëse plotësohen kushtet e përcaktuara nga Akti Normativ dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në të.

Në lidhje me pyetjen tuaj nëse konsiderohen subjekte të Aktit Normativ, subjektet që paguajnë tarifë trajtimi pranë UK, ju sqarojmë se bazuar në nenin 6 të të Rregullores Teknike, pikat 1 deri në 12 të nenit 2, nenit 3 të Aktit Normativ, subjekte të këtij akti janë të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari ekonomike në zonat bregdetare dhe bregun e liqeneve e të lumenjve, të lidhura ose jo me rrjetin publik të kanalizimeve. Si pasojë Task-Forca ushtron kontroll dhe merr masa administrative ndaj këtyre subjekteve, pa u varur nga fakti nëse ato janë lidhur me rrjetin publik të kanalizimeve. apo paguan tarifë trajtimi pranë UK.

Në lidhje me kërkesën për informacion mbi numrin e masave administrative të vendosura në Bashkitë që ju keni përmendur, ju vëmë në dijeni se janë vendosur **8 masa administrative** në Bashkinë Kavajë, **21 masa administrative** në Bashkinë Durrës, **14 masa administrative** në Bashkinë Vlorë dhe **29 masa administrative** në Bashkinë Sarandë.

Në lidhje me kërkesën për informacion rreth ushtrimit të kontrolleve ndaj subjekteve të cilat ju keni përmendur, ju informojmë se deri më sot, Task-Forca ka mbajtur akte kontrolli ndaj 13 subjekteve. Për 2 subjektet e mbetura, ju informojmë se ata nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Aktit Normativ nr.8, datë 28.12.2023, pasi për njërin prej tyre nuk përmbushet kushti i vendodhjes në zonë bregdetare apo në bregun e liqeneve e të lumenjve, ndërsa subjekti tjetër nuk përfshihet në asnjë prej subjekteve të parashikuara nga pika 1 deri në 12 të nenit 2 të Aktit Normativ.

Për çdo sqarim të mëtejshëm, institucioni mbetet në dispozicionin tuaj.